

Fjalat e Paqes



*Shkoni e bëni
nxënës të mi
të gjithë popujt,
pagëzoni në emër të
Atit e të Birit
e të Shpirtit Shenjtë
Mt. 28, 19*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 3 (140) Viti XX Prill - Maj 2018**

Editorial

Shqipëria, para pak javësh mori nga Këshilli i Evropës rekomandimin për hapjen e negociatave për të vijuar procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian. Siç bëhet me dije, duhej shumë punë për të arritur deri këtu, por duhet akoma shumë punë për të përmbushur këtë aspiratë. Përgjatë historisë nuk mund të përcaktohet sa e ka dashur Evropa vendin tonë, por padyshim mund të thuhet se pjesa e urtë dhe ajka e popullit tonë kanë pasur gjithmonë qëllim që populli ynë të rreshtohet krahas vendeve evropiane, pra atyre perëndimore. Dhe kjo, jo pa qëllim. Evropa dhe perëndimi kanë mbajtur ndër shekuj disa vlera dhe mentalitet shtetformues ku e mira e përbashkët dhe e mira e personit duhet të përfshijnë njëra-tjerën. Si çdo popull edhe ne patëm historinë tonë, por jo si shumëkush e bëmë historinë tonë. Qemë të pushtuar dhe njohëm shumë pak kohë shije lirie e vetëqeverisje. Edhe atëherë kur e patëm lirinë, ishim mësuar të sundoheshim keq e nuk ditëm të ndërtonim në liri. Shumë popuj fqinj e dashamirë na ndihmuan por shumë të tjerë gëzoheshin më rrëzimet tona, e madje kishte edhe ka nga ato që bënë çmos që të shijonim veç rënie. E populli ynë, fatkeqësisht, pothuajse në të gjitha legjendat e tija e madje edhe ngjarjet historike ka pasur një “Kain-Hamza”. Pasi u pamvarësua, dilte dikush i yni e na përçante më keq se pushtuesat. Gjithmonë i kemi filluar punët mirë por i kemi zhvilluar jo me të njëjtin entuziazëm, e hera-herës i kemi braktisur ëndrrat rrugës e kemi veshur petkun e zheltë të revoltave kundër vetes. Mjerisht, disa nga ne akoma i duan pushtuesit e diktatorët më shumë se veten.

Prandaj të dashur lexues, ju ftoj më dhe ju nxisim që të korigjojmë “Kainin-Hamza” (nëse e diktoni në ndërgjegjen tuaj personale) me virtytet e atdhedashurisë që do të thotë dashuri për të afërmin më së pari dhe për vendin ku Krijuesi ta dhuroi jetën. Të angazhohemi së bashku për ta bërë Shqipërinë vend të drejtë e të jetueshëm duke ndihmuar njëri-tjetrin me dritën e dashurisë ungjillore.

Evropë dhe Amerikë nuk do të thotë më shuma para apo më shumë mundësi. Nëse nuk ndryshojmë sjellje (të japësh që të të japin) ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj të mirës së përbashkët, nëse nuk *ndeizim një qiri në errësirë por rrijmë e mallkojmë atë*, Evropa dhe Amerika do të jenë sërish “pushtuesit” modernë për atë që nuk diti kurrë të ndërtojë në liri.

Zoja e Këshillit të mirë, Nënë Tereza dhe Martirët e fesë bekoreshin çdo përpjekje që populli ynë të jetojë si aspiro e të jetë pjesë e identitetit të tij gjeo-historik.



Porosi e Hirësisë së Tij, Ernest Troshani, drejtuar deputetëve të Parlamentit Shqiptar në seancën

“Nuk kam ardhur për t’ju mësuar gjëra të reja, por kam ardhur që të falenderoj atdheun dhe popullin, që pas një “rrebeshi” prej 5 dekadash, më në fund gjeti forcën shpirtërore për t’i njohur bijve dhe bijave të tij që për të ruajtur lirinë e ndërgjegjes dhe besimit, nuk e braktisën popullin e vet. Jam dëshmitari i fundit i një brezi klerikësh katolikë që vuajtën dhe u persekutuan. Duke më bërë kardinal, Papa Françesku nuk më nderoi vetëm mua, por të gjithë Kishën Katolike Shqiptare dhe të gjithë popullin shqiptar”.

“Të nderuar deputetë, përpiquni të gjithë bashkë që kur çdonjëri të shohë në sytë tuaj, të shohë begatinë, drejtësinë, bujarinë dhe bekimin hyjnor. Qëndroni më afër problemeve të popullit shqiptar dhe bëni që politika të jetë shërbim e jo përfitim. Vetëm atëherë do të keni respektin e njerëzve të thjeshtë që kanë besuar te ju”.

2

Deklaratë e besimeve fetare në Shqipëri
*me rastin e rekomandimit
për hapjen e negociatave me BE*

5

Imzot Simon Kulli
Homeli në vitin e Gjergj Kastriotit

6

Imzot Angelo Massafra
25 vite nga vizita e Gjon Palit II

10

Visar Zhiti
Letërsi e vrarë ...



Deklaratë e besimeve fetare në Shqipëri me rastin e rekomandimit për hapjen e negociatave me BE

Ne, Komunitetet fetare të pranishme në Shqipëri: Komuniteti Mysliman, Kisha Orthodhokse, Kisha Katolike, Komuniteti Bektashi dhe Vëllazëria Ungjillore, shprehim përgëzimet më të përzemërta për popullin tonë shqiptar, me rastin e marrjes së rekomandimit pozitiv nga ana e Komisionit Evropian për çeljen e negociatave me BE.

Rrugëtimi ynë drejt Evropës, aty ku ne përkasim natyrshëm, është tashmë një fakt dhe një dëshirë e popullit tonë. Etërit themelues të shtetit shqiptar, ndër të cilët ishin edhe klerikë të besimeve tona fetare, ishin të bindur për këtë përkatësi. Po ashtu, në kohët më të vona udhëheqësit fetarë të Shqipërisë, nuk kanë dyshuar kurrë për vokacionin evropian të shqiptarëve, vokacionin për një shoqëri të lirë, ku të gjithë të ushtrojnë të drejtat e tyre, përfshi edhe të drejtën themelore të besimit. Ne besojmë se liria e fjalës dhe e besimit, familja, paqja, solidariteti, janë vlera mbi të cilat mbështetet edhe shoqëria jonë, që aspiron të jetë pjesë e familjes evropiane.

Ne Komunitetet fetare në Shqipëri ofrojmë një model të harmonisë dhe të vëllazërimit, si një shërbim ndaj njeriut, shoqërisë dhe ndaj aspiratave të ligjshme të popullit tonë, ndër të cilat është edhe hyrja në familjen evropiane. Kjo harmoni dhe ky model është një pasuri që ne sjellim dhe mbartim me vete në rrugëtimin tonë drejt Evropës dhe është një e mirë për vetë shtetet që sot përbëjnë këtë organizim politik e shoqëror. Shumë herë është theksuar që kjo është një vlerë e çmuar e jona. Për këtë ne jemi të gëzuar dhe entuziastë dhe jemi gjithashtu të angazhuar ta promovojmë në çdo rast dhe kudo, duke punuar që ajo të mos cenohet, as nga faktorë të brendshëm e as nga nxitje keqdashëse të jashtme.

Me këtë rast ne i bëjmë një thirrje me ngulm dhe vendosmëri ndërgjegjes së të gjithëve, politikës në përgjithësi e qeverisjes në veçanti, që të vazhdohet puna me përkushtim nga ana e të gjithëve për përmbushjen e standardeve që duhen për të qenë pjesë e Evropës. Në mënyrë të veçantë duam të theksojmë përpjekjet për reformën në drejtësi, për të cilën kemi pasur rast të flasim edhe në deklarata tona të mëparshme. Po ashtu lufta ndaj korrupsionit dhe

ndaj varfërisë së shqiptarëve. Nuk duhen mbyllur sytë ndaj shtresave në nevojë, ndaj punësimit të të rinjve dhe subvencionit të familjeve në vështirësi, nëpërmjet skemave të drejta të asistencës sociale. Prosperiteti ndërtohet me punë dhe duhet të intensifikojmë përpjekjet që kreativiteti dhe energjia e rinise shqiptare, si edhe kontributi i sipërmarrësve tanë, të vlerësohen e inkurajohen. Në këtë mënyrë do të ndalet hemorragjia e shumë të rinjve dhe familjeve drejt vendeve të tjera, por edhe dëshpërimi që kaplon shpesh të rinj e të reja të vendit tonë. Duhet të nxisim e të japim shpresë për të ardhmen në vendin tonë. Duhet të bëjmë detyrat mirë që më pas kryelartë të kërkojmë mbështetje nga të gjitha vendet e Evropës.

Një thirrje e fundit, por shumë e rëndësishme nga të gjithë ne religjionet bashkë, i shkon Kancelarive perëndimore. Nëpërmjet ambasadave të tyre, të akredituara në Tiranë, ne u kërkojmë shteteve anëtare të BE që të mbështesin akoma më fuqishëm këtë proces. Është në të mirën e Evropës që edhe shqiptarët, e pse jo i gjithë Ballkani perëndimor, të jenë pjesë e saj. *Ne shqiptarët jemi pjesë e Evropës dhe sigurisht pa njëri-tjetrin jemi mangut: ne pa Evropën dhe Evropa pa ne.* Na bashkon një histori më e gjatë se sa e këtyre dekadave të fundit. Është një histori mijëra vjeçare dhe janë rrënjët e përbashkëta kulturore e shoqërore që ne kemi e që na lidhin. Ne ju bëjmë thirrje përzemërsisht, por me vendosmëri, që të mbështesni hapjen e negociatave dhe sa më shpejt edhe anëtarësimin në BE të vendit tonë.

Të bindur se fjalët tona nuk do të bien në vesh të shurdhër, ne ripërtërijmë angazhimin tonë që nëpërmjet lutjes drejtuar të madhit Zot dhe fjalës tonë nëpër komunitetet tona, të jemi gjithmonë mbështetës dhe promovues të vendosur të së mirës, të paqes dhe të shpresës për të ardhmen.

Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe ne të gjithëve.



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë
Kisha Katolike
Kryegjyshata Botërore e Bektashinjëve
Vëllazëria Ungjillore

Mësim nga Papa Françesku



Do të doja të përfundoja me dy anekdota nga dy rrëfyes të mëdhenj, të dy nga Buenos Aires.

Njëri, një prift sakramentin, i cili edhe pse kishte punë të rëndësishme në kongregatën e tij duke qenë provincial, gjente kohë për të shkuar në rrëfime. Unë nuk e di se sa, por shumica e klerit të Buenos Aires shkonin të rrëfeshin tek ai. Edhe kur Shën Gjon Pali II erdhi në Buenos Aires dhe kërkoi një rrëfyes, e thirrën nga Nunciatura për të rrëfyer Papën. Ai ishte njeri që jepte shumë kurajo për të ecur përpara. E kam përjetuar këtë gjë sepse jam rrëfyer tek ai në kohën kur isha provincial i jezuitëve, e shkoja tek ai për të mos shkuar tek drejtori im jezuit ... Kur fillonte thoshte: "mirë, mirë, është mirë" dhe të inkurajonte: "shko përpara!". Sa i mirë ishte. Ai vdiq në moshën 94 vjeçare dhe rrëfente deri një vit para se të vdiste. Edhe kur ai nuk ishte në rrëfystore mjaftonte t'i bieje ziles së derës dhe ai do të zbriste menjëherë. Një ditë, kur isha vikar i përgjithshëm, dola nga dhoma ime dhe shkova aty ku ishte një faks zyre. Kështu bëja herët çdo mëngjes sepse doja të shihja lajmet e para të ditës. Ishte e Diela e Pashkëve dhe kishte një faks: "Dje, gjysmë ore para vigjiljes së Pashkëve, vdiq at Aristi ", kështu e quanin ... Më pas shkova për drekë tek priftërinjtë e moshuar për të kremtuar Pashkën së bashku. Rugës për në shtëpi, hyra në një kishë të vogël në qendër të qytetit. Kishte një arkivol dhe dy zonja të vjetra po thonin rruzaren. U afrova pranë arkivolit dhe pashë se mbi të nuk kishte asnjë lule. Mendova, por ky është rrëfimi i të gjithëve! Kjo më preku. Ndieva se sa e rëndë është vdekja. Dola dhe u drejtova te një qoshk, 200 metra më tej ku shiteshin lule. Ndërkohë që po vendosja lulet në arkivol, pashë rruzaren në duart e tij. M'u kujtua urdhërimi i shtatë që thotë: «Mos vidh!». Bëra sikur po rregulloja një lule dhe e mora kryqin. Që prej asaj dite, atë kryq e mbaj me vete gjithmonë dhe i lutem për mëshirë. Kjo ka ndodhur rreth vitit 1996.

*Mbatur për Misionarët e Mëshirës (rrëfyesat)
në sallën Mbretëresha në Vatikan më dt. 10 prill 2018*

Presidenti i Republikës, me datë 29 maj 2018, vlerësoi Hirësinë e Tij,
Kardinalin shqiptar Ernest Simoni (Troshani) me Dekoratën
“Gjergj Kastrioti Skënderbeu” me motivacionin:

“Kardinalit të shquar shqiptar, përfaqësuesit të brezit të jashtëzakonshëm të klerikëve katolikë që jetën ia kushtuan besimit të palëkundur ndaj Zotit, dashurisë së pakushtëzuar ndaj njerëzve, vlerave të larta shpirtërore dhe morale, lirisë së ndërgjegjes e qëndresës dinjitoze në shërbim e në respekt të atdheut dhe kombit”



KONFERENCË E PËRBASHKËT: KATOLIKË, ORTHODOKSË, MUSLIMANË DROGA – FAJDET – LOJRAT E FATIT

Pasditën e datës 13 prill 2018, në Kinema “Millennium” në Shkodër, u zhvillua një takim i thirrur dhe i organizuar tre komunitetet fetare më të mëdha të qytetit të Shkodrës, që përfaqësoheshin nga drejtuesit e tyre: Imam Muhamed Sytari për Komunitetin Mysliman; Ipeshkvi ynë, Imzot Angelo Massafra, për Komunitetin Katolik dhe Atë Nikolla Petani për Komunitetin Ortodoks.

Tema e këtij takimi me karakter informues dhe ndërgjegjësues, ishte “Dëmet që i sjellin shoqërisë droga, lojërat e fatit dhe fajdetë”. Më poshtë po sjellim pjesë nga ligjërata e Dom Marjan Gega.

Droga.

Ndonëse është dicka e re për shoqërinë moderne shqiptare, me sa duket është bërë një fenomen që kërkon vëmendje të shumëanshme për një përsiatje të mirëfilltë që mund të japë ndonjë fryt. Sigurisht përballë plagëve të tilla sociale, as individi, as familjet e vetme, madje as institucionet e vetme nuk mund të përballojnë situatën. Prandaj jemi edhe ne sot këtu për të dëshmuar angazhimin tonë të përbashkët. Bashkësitë fetare nuk janë një trup i huaj në lamin e shoqërisë, por pjesë integrale e saj. Në rrafshin shoqëror nuk janë vetëm konsumuesit problem. Njerëzit e botës së krimit të cilët duan të përfitojnë mbi dobësitë e tjerëve e janë të shumtë e në çdo vend të botës janë ende njerëz me pushtet (mors tua vitae mea). Shikojeni se çfarë po ndodh në Shqipëri vitet e fundit. S'ka nevojë për koment.

Ka edhe një problem të jashtëzakonshëm që është deformimi i tregut nga paratë e pista. Kështu po ngjeshin shkallët e distancave të paarritshme një pakicë dhe po humbasin shpresën shumica dërrmuese. Si mund të kultivojë duhanin sheldisori, perimet ai prej Drishtit, përballë një trysnie aq të madhe që ushtron prodhimi i canabis? Por jo vetëm këtu, por po të hysh e të bësh një kërkim fare të shpejtë në web, do të shohësh që përdorues dhe trafikantë droge me origjinë nga Shqipëria dalin në shifra të frikshme. Si mund të konkurojë hoteli i një velipojaku që veçsa ka tokën si të vetmen pronësi e pasuri, në krahasim me ata që po pasurohen nga tregtia e drogës. Prandaj nëse do duhej që ndonjëherë të bënim moral, le ti lusim njerëzit të marrim masa të vogla por konkrete: duke bërë zgjedhje preferenciale me bizneset e vogla...

Zgjidhjet kush janë? Izolimi i të rinjëve përdorues, dmth burgu? Kurimi i tyre? Eliminimi i tyre në mënyrën e presidentit të Filipineve? Me siguri problematika është më e gjërë. Duhet parë që në mënyrën e edukimit të fëmijëve në familje. Në këtë pikë kemi mundësi të japim shumë më tepër ne si përfaqësues fetar.

Kam një vërejtje e një nxitje për debat: a më duket mua apo ne harxhojmë më shumë kohë në diskutime morale se ato njerëzore?

Pra problemi është i dyfishtë dhe është njerëzor:

* dikush përdorues sepse ndihet dështak ose do të bëjë interesantin

* dikush trafikant sepse është i etur për para të shumta dhe shpejt.

Fajde

Në Besëlidhjen e Vjetër praktika e dhënies borxh me interes ishte e ndaluar (nëse ti i jep hua dikujt prej popullit tim, ose të varfërit që është me ty mos u sill si fajdexhi: ju nuk duhet ti vini asnjë interes ne kthim – Dal, 22,24). Ndërsa në librin e Levitikut 25, 35/37 do të gjejmë një pjesë tjetër “nëse një vëlla i yti bie në mjerim dhe nuk ka me çfarë të jetojë, ndihmoje...mos pretendo nga ai interesa, as të mira”.

Një hebreu i ishte e ndaluar fajdja me hebrenjtë, por jo me të tjerët. Në fakt në mesjetë edhe më heret do të gjejmë se fajdexhinjtë e parë do të jenë pikërisht hebrenjtë. Për të krishterët ishte pak më e komplikuar çështja sepse në konceptimin e ungjillit, vëlla është çdo njeri, atëherë ishte gjithmonë e palejueshme të praktikohet fajdja. Për moralin e krishterë, ashtu si për mendimin e Aristotelit, fajdja është konsideruar si mëkat kundër natyrës pikërisht për formën e fitimit të lekut nga leku, pasi në vetvete leku është vetëm mjet shkëmbimi dhe jo prodhues.

Në koncilin e Lateranense III, 1179 filloi shkishërimi i fajdexhinjëve duke ua ndaluar deri edhe varrimin në tokën e bekuar nëse nuk do të kthenin të gjithë fitimin e pandershëm. Ndërsa në Koncilin e Vienes, 1311/12 u shtua edhe më tepër masa duke deklaruar heretik çdokënd që mund të pohonte se fajdja nuk është mëkat.

Dante Alighieri, në këngën e XVII të Ferrit, i vendos fajdexhinjtë në rrethin e rezervuar koprracëve të cilët janë të pangishëm dhe të rëndë në krenari.

Më vonë në mesjetë, Kisha filloi të hapet dhe pranoi nevojën e qarkullimit të likuiditetit si mundësi më e madhe zhvillimi ekonomik. Të mendojmë se në atë kohë ishte sistemi feudal, ku pasuria ishte për trashigimi e jo shprehje e aftësive menaxhuese të individëve. Me fjalë më të thjeshta: dikush kishte paret e dikush kishte mendjen. Këta të fundit kishin nevojë jetike për lekë, ndërsa atyre të parëve iu mykeshin lekët. Të parët që revucionalizojnë mendimin e Kishës që konsideronte paranë sterile e për pasoje mëkat: fitimin e lekut nga leku, me një kurajo të jashtëzakonshme, janë fretnit e Monte della Pieta, që më vonë do të lindë dhe ekziston edhe sot e kësaj dite Banka e Monte dei Paschi di Siena. Ata hyjnë garant para të pasurve për të lëshuar paratë e tyre në dorë të individëve tregtar. Lind kështu sistemi bankar i kreditimit të ligjshëm.

Po sot pse ka kaq shumë fajdexhinjë në të gjithë botën? Po në Shqipëri cilat janë specifikat që është kaq i përhapur ky fenomen? Janë shumë arsye por unë po rendis vetëm disa:

* sepse sistemi financiar i bankave është kthyer gati në fajde

*sepse garacitë që kërkojnë bankat janë tepër të mëdha dhe interesat e huazimit tejkalojnë mundësitë normale të çdebitimit

* burrokracia dhe klientelizmi nga ana e bankierëve

* ekonomia informale (shteti duke mos bërë aksioner të punëve publike qytetarët që kanë pak financa ...)

* paratë e krimit

* injoranca e qytetarëve në fushën ekonomike

* korrupsioni masiv i qeveritarëve

të gjitha këto janë premisa për paranë që qarkullon në të zezë që gjenerojnë padrejtësi, varfërim të tejskajshëm të atyre që mendojnë se kanë ide dhe financimin e gjejnë në rrugë primitive si dhe krim të pashmangshëm.

Në thelb është e njëjta situatë si me drogën. Egoizmi njerëzor shtynë dikënd të rrezikojë më tepër se ç’është e mundur për individin ose familjen si dhe krijimin e strukturave mafioze të mirëfillta.

Strukturat tona fetare nuk mund të mbështesin financiarisht njerëzit viktimë, por mund të bëjnë shumë më shumë po të kishte mundësi financiare me anën e edukimit njerëzor. Tek asistenca dhe formimi qëndron sekreti i përkrahjes së viktimave, por edhe gdhëndja sadopak e ndërgjegjes së humbur të fajdexhinjëve (të cilëve duhet tu afrohem i jo me përçmim, por me kurajo ti ftojme për një kthim të mendjes e zemrës për një jetë më të drejtë kundrejt qelizave më të dobta të shoqërisë).

Lojërat e fatit

Lojëra të tilla mjegullojnë mendjen, hipnotizojnë dhe asgjësojnë arsyetimin. Dikush luan prej viteve dhe nuk fiton ose fiton tepër pak, por ka gjithmonë “shpresën” se një ditë do fitojë shumë dhe nuk tërhiqet asnjë herë nga ky ves skllavërues. Nuk ndihen në faj asnjëherë për çfarë bëjnë sepse një biletë, një skedinë kushton pak. Por në fakt po të bësh llogaritë del krejt e kundërta.

Lojërat e fatit janë të bazuara mbi iluzionin se një ditë do të ndryshosh jetën tënde. Me një naivitet të paparë vazhdon të mendosh se ai momenti fatlum do të vijë. Humb dhe vazhdon të besosh. Këtë besim të verbër vazhdojnë ta ushqejnë publicitetet e shumta, në pikun e ndjekësve të publikut, shpesh në orare siç janë vakthet e bukës kur e gjithë familja është e bashkuar. Kjo bën që të hiqen edhe ndjenja e turpit të një babai përballë bashkëshortes ose fëmijëve. Dalgadalë hyhet në një rreth vesi në të cilin ngushëllohesh vetë se nuk je vetëm. Si duhet vepruar me të tillë persona? Si mund ti orjentojmë ata?

* Loja nuk është një organizatë bamirësie. Lojës nuk i intereson se çfarë të nevojitet ty, apo cilat janë problemet e tua? Lojrat e fatit janë një sistem djallëzor të krijuara vetëm për të të marrë lekët në shuma të vogla e të përditshme. Për më tepër “hilja” është ajo që mbretëron.

* Loja është vetëm një iluzion e nuk është një prind i mirë që të jep pak lekë përditë kur nisësh për shkollë.

* Varësia nga lojrat e fatit është një shprehje papjekurie, një mënyrë për të gjetur rrugë të shkurtëra për jetën, një shtyrje e mundësisë për tu rritur dhe për të pare ballë për ballë realitetin.

MESHË PËR GJERGJ KASTRIOTIN
21 prill 2018

Predikimi i mbajtur me rastin e 550 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti, në Katedralen e Lezhës!

Fort të dashur vëllezër në Episkopat, të dashur Meshtarë.
Të nderuar autoritete qendrore dhe lokale
Të dashur vëllezër dhe motra të ardhur nga dioqezat tona dhe nga Kosova e Mali i Zi!
Jubileu i Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti – “Skënderbeu”, na bashkoi sot në këtë katedrale të Lezhës për të kremtuar këtë Liturgji hyjnore në dobi të Kombit tonë, që urtia e drejtuesve dhe ndershmëria e shtetasve të nxisin në këtë Atdhe harmoni dhe drejtësi në mënyrë që të mund te jetojmë të lumtur dhe në paqe. Ky është edhe qëllimi për të cilin e kremtojmë këtë Meshe Shenjte!
Vëllezër dhe motra fort të dashur,
Gjergj Kastrioti mbetet simboli më i përkryer i bashkimit, sakrificës dhe dashurisë për atdheun për të gjithë Shqiptarët e çdo kohe, madje dhe më gjerë.. ndikimi i tij tejkalonte trojet tona duke gëzuar nderimin e vendeve evropiane dhe të papëve të Romës. Dëshiroj të bashkëndaj me ju shkrimin e papës Pali VI me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Heroit tonë:
Ja çfarë shkruante Papa Pali VI për Heroin tonë në 500 vjetorin e vdekjes: “Pararendësit tanë e mbuluan me elozhe më tepër se çdo hero të asaj epoke. Ai arriti të ruante për njëzet e pesë vjet prej pushtimit atdheun e tij, i cili ishte pika më e brishtë e sistemit mbrojtës të krishtërimit. Për këtë arsye, pararendësi ynë, Kaliksti III, duke patur parasysh devocionin dhe atashimin ndaj Selisë apostolike të këtij kapedani, tha për të me të drejtë se ai kishte merituar më shumë nga të gjithë princat katolikë lëvdata për nder të besimit dhe fesë katolike”.
Nga këtu mund të vëmë re se binomi Fe - Atdhedashuri ishte skalitur thellë në jetën e heroit tonë kombëtar. Ai e kishte kuptuar shumë mirë se vetëm në Krishtin gjendeshin fjalët e jetës së pasosur. Këtë të vërtetë ai e dëshmoi dhe u përpoq, (u mundua) që Krishti dhe Fjala e tij e pasosur të shtrihej në çdo popull. Për këtë luftoi dhe u tregua vërtetë si Atletë Christi.
Vëllezër dhe motra fort të dashur!
Historia e Shqipërisë sa e lavdishme aq edhe e mundimshme është shënuar përjetësisht nga heroit ynë kombëtar, i cili jetoi për aspiratat më të larta dhe më të denja që mund të jetojë njeriu i çdo kohe dhe i çdo vendi. Dashuria e tij e pakushtëzuar për Liri, Fe dhe Atdhe i dhuroi Evropës dhe gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen një trashëgimi të paçmueshme. Falë tij dhe dëshmorëve tanë në trojet tona valëvitet krenar flamuri ynë.
Prandaj mbi ne bie detyra e rëndë dhe fisnike për të përvetësuar po ato ndjenja, të frymëzohemi nga jeta e tij dhe të imitojmë në jetën e përditshme stilin e jetës së Heroit tonë, po edhe të shumë martirëve, në mënyrë që ky vend të dojë më tepër lirinë, Zotin dhe atdheun.
Ne, bijtë e Gjergj Kastriotit, jemi të lirë në botën e sotme demokratike, e pikërisht sot jemi të ftuar të reflektojmë, nën dritën e këtij Burri fisnik, të pyesim veten si po e përdorim këtë liri e sa na ndihmon demokracia për të kapërcyer vështirësitë e jetës? Cilat janë pikat e referimit, që duhet të mbeten të patundura në shoqërinë tonë Shqiptare? Vëllezër e motra, ia vlen të sjellim shpesh në mendje e të nxejrrim mësim nga e ashtuquajtura “porosia e fundit e Skendërbeut” mbi bashkimin: Tufën e thuprave nuk mund ta thyejë as më i fuqishmi nga ju. Prandaj qëndroni të bashkuar sepse edhe pa mua do të fitoni.”
Të mos harrojmë se të shumë janë shqiptarët të cilëve jeta nuk u jep shumë mundësi, në vend të dorës së shtrirë të shpresës gjejnë para

vetes grushtin e shtypjes e përpjekjen e manipulimit. E këta nuk janë situata të lehta, por mendja e zemra na shkon (e kemi fjalën) për të varfërit, për njerëzit pa shtëpi dhe pa bukë e gojës, për viktimat e dhunës e të degradimit, për të gjithë ata që kërkojnë me patjetër të braktisin vendin duke u larguar nga Shqipëria. Shkaqet e situatave të tilla problematike janë të ndërlikuara, të gjitha kanë të përbashkët mentalitetin e helmuar, që shfaqet në trajtimin e personave si të ishin thjesht sende, duke afirmuar kështu një pandjeshmëri zemre, që më parë injoron e pastaj vë në lojë dinjitetin dhe lirinë që Zoti i jep çdo shqiptari dhe çdo njeriu...”
Liria e vërtetë është shenjë e privilegjuar e figurës Hyjnore në zemrën e njeriut. Për lirinë mijëra njerëz, në trojet tona luftuan, pësuan persekutime të tmerrshme, dhuruan edhe jetën. Pikërisht këta janë njerëzit më të denjë për t'u kujtuar përjetësisht.
Heroi ynë Kombëtar na mëson se vetëm kur i nënshtrohemi si bij, Zotit, Atë i mirë, atëherë liria jonë merr kuptimin e vërtetë, sepse buron nga dashuria e Zotit. Pikërisht prej kësaj marrëdhënie të sinqertë me Zotin, burojnë edhe marrëdhëniet e drejta mes nesh, mes udhëheqësve të popullit e pastaj edhe mes kombeve.
“Liri njerëzore është, nga njëra anë, të lundrosh në gëzimin e në hapësirën e madhe të dashurisë së Zotit, por nga ana tjetër edhe të jemi njëri për tjetrin e njëri me tjetrin. Nuk ka liri kundër tjetrit. Pasi e vërteta, që buron nga dashuria për Zotin, na bën të lirë e të aftë për ta dashur edhe të afërmin.
Prandaj sikurse e kemi nënvizuar edhe në ngjarje të tjera të mëdha për vendin tone në këto vite, nuk mund të mos i gëzohemi edhe një bilanci pozitiv, sidomos në fushën e lirisë e të drejtave të njeriut, të lirisë së shprehjes së besimit, të fjalës dhe të mendimit. Lëvizja e lirë e qytetarëve, formimi i një kuadri ligjor gjithnjë e më të aftë për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë dhe demokratizimi i mëtejshëm i vendit janë sinjale që premtojnë për një integritet sa më të shpejtë të Shqipërisë në familjen e madhe evropiane. Vetëm në këtë mënyrë, atdheu ynë do të shmangë përfundimisht rrezikun e izolimit nacionalist. Një atdhe i vërtetë është vetëm një atdhe i lirë, për kombet e tjera dhe me kombet e tjera, duke qenë në një proces të vazhdueshëm dhëniejeje e marrjeje.
Sot, në ungjill kemi dëgjuar besnikërinë e apostujve ndaj Krishtit, që shpreh bashkimin e tyre të sinqertë me Mësuesin dhe na bën thirrje edhe neve sot, që të shohim në besnikërinë e përditshme forcën për të ndjekur Krishtin kudo ku Ai na thërret që të shërbejmë dhe të jetojmë.
Duke dashur të hedhim vështrimin mbi të ardhmen e atdheut tonë, Le të na nxisë ky vit jubilar të gjithëve që të jemi më vigjilentë për të ruajtur “bashkësinë”, për të thelluar “bashkimin” me të gjithë për të mirën e madhe të kombit tonë, e për të promovuar “njësinë” kombëtarë më të dukshme, më të prekshme, përmes solidaritetit, mbjelljes tek të rinjtë dëshirën për të kontribuar për ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë këtu në këtë vend të mrekullueshëm.
Nga bashkimi me Zotin rreth altarit le të marrim energjinë e domosdoshme e frymëzimin për të rinovuar zemrën e mendjen tonë për më shumë vepra konkrete dashurie ndaj Kombit tonë.
Kjoftë lëvdu Krishti.

Imzot Simon Kulli
Ipeshkëv i Sapës



Më datën 25 prill 2018, në festën e Sh’Markut ungjilltar, u mbushën 25 vite nga vizita e parë e një Pape në tokën tonë shqiptare, vizita e Shën Gjon Palit II. Dioqeza e Shkodër-Pult e kujtoi këtë ngjarje historike me një meshë falenderimi Zotit që u mbajt në Kishën katedrale. Meshën e udhëhoqi Sh. T. Imzot Angelo Massafra. Më poshtë po ju paraqesim të plotë homelinë e tij në këtë përvjetor.

Shumë të dashur vëllezër e motra,

përkujtimi liturgjik i shën Markut ungjilltar ka për ne, këtë vit, shijen e përkujtimit mirënjohës ndaj Zotit për rilindjen e Kishës Katolike në Shqipëri kur, 25 vjet më parë, shën Gjon Pali II rithemeloj episkopatin shqiptar duke shuguruar ipeshkvijtë e parë pas periudhës së trishtuar dhe të errët të diktaturës komuniste. Dhe ky jubile arrin, në mënyrë provanore, një vit pas kujtimit të trishtueshëm të 50-vjetorit të dekretit të mbylljes së kishave të zbatuar nga diktatori.

Të dashur, edhe 20 vjet përpara, si sot, kam filluar t'i shërbej kësaj Arqidioqeze si Arqipeshkëv, për këtë falënderoj, së bashku me ju, Krishtin “Bari i Mirë” dhe Papa Shën Gjon Palin e Dytë qoftë për shugurimin Ipeshkvor qoftë për këtë emërim.

Nga Pashka e Krishtit kemi sigurinë e vërtetësisë së misterit pashkor që Kisha dhe të krishterët jetojnë gjithmonë: pra misterin e vdekjes dhe të lavdisë, në një alternim që ritmon ekzistencën tonë në ecje drejt Atdheut qiellor.

Por për përkujtim e lumë të ardhjes së Papës, do të kemi rastin të flasim nesër, kur së bashku, si bashkësi kishtare e gjithë Shqipërisë do t'i shprehim falënderimin tonë Zotit në kremtimin solemn eukaristik që do të përjetojmë pranë Shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë.

Sot duam të ndalemi të reflektojmë në lidhje me gjallërinë e Kishës sonë në ditët tona që, në shëmbëlltyrë të Kishës së parë, është e thirrur gjithmonë që “të rithemelohet” mbi elementet përbërëse që e karakterizojnë. Në fund të fundit, pikërisht këtë jemi duke u përpjekur të bëjmë në Kishën tonë:në Letrën Baritore që ju kam dërguar përmbahet Projekti Baritor trevjeçar që, edhe një herë, ju ftoj ta merrni në duar për ta aktualizuar; si dhe nëpërmjet reformës së zyrave të Kuries dioqezane dhe funksionalitetit të tyre nuk dëshirojmë të bëjmë një operacion thjesht burokratik, por një veprim të frymëzuar prej Ungjillit dhe prej Traditës së Kishës së gjithëmbarshme.

Ungjilli që shpallëm, megjithëse bëhet fjalë për një shtesë në bërthamën origjinale të Ungjillit të shën Markut që duhej ta përfundonim me shpalljen e centurionit: “Ky njeri paska qenë me të vërtetë Biri i Hyjit!”, na flet për natyrën misionare të Kishës. Nuk ekziston dishepullat, pra nuk ekziston Kishë pa mision. Prandaj Projekti baritor që kemi përgatitur për këta tre vjet shtjellohet përreth rifitimit të identitetit tonë të krishterë, të mbështetur në njohjen e Jezusit, dhe do të përfundojë pikërisht me angazhimin misionar që jemi të thirrur të marrim përsipër të gjithë personalisht: një ecje pas personit të gjallë të të Ringjallurit që, sot, na ka përsëritur: “Shkoni, predikoni, pagëzoni që të shëlbohen!”.

E megjithatë duhet të bëjmë kujdes që të mos e ngatërrojmë urdhrin e Zotërisë me një ftesë për të bërë proselitizëm: veprimi misionar buron, siç po thoshim, prej kuptimit të identitetit tonë si të Krishterë duke iu referuar Krishtit. Prej këtu buron jeta e re në të Ringjallurin që bëhet për jobesimtarët një dëshmi e gjallë që i mahnit dhe i tërheq njerëzit nga Krishti. Detyra e besimtarit është të dëshmojë dhe të sjellë Krishtin. Të tjerat do t'i bëjë Ai me fuqinë e Shpirtit Shenjt.

Dhe se cila është jeta e re e të Krishterit na e ka përshkruar qartë shën Pjetri në leximin e parë: para së gjithash përvujtëria që është garanci e dashurisë vëllazërore, e vetmja formë me të vërtetë e fuqishme e dëshmisë. Vetë Jezusi ka thënë: “Nëse e doni njëri-tjetrin të gjithë do t'ju njohin se jeni nxënësit e mi”. Pra, jo zotësia e besimtarit si individ (qoftë ai laik, i kushtuar apo meshtar) por forca e një bashkësie të

karakterizuar prej dashurisë vëllazërore.

Në radhë të dytë besimi në dorën provanore të Hyjit, vazhdimisht të shtrirë drejt bijve të vet për të cilët ka kujdes dhe të cilët nuk i lë kurrë vetëm në vështirësi. Pas çdo veprimtarie tonë, qoftë si individë qoftë si bashkësi të krishtera, duhet, pra, t'i lejojmë Hyjit të veprojë me fuqinë e vet dhe jo me demostrimet tona të forcës. Ta kujtojmë gjithmonë atë fjalë të Jezusit që thotë: “Pa mua nuk mund të bëni asgjë”.

Në radhë të tretë përndjekja. Po, vëllezër e motra: përndjekja! Është diçka e vështirë për t'u pranuar që për të qenë nxënës të Krishtit duhet edhe të pësojmë përndjekje, por është një realitet: një dëshmi e mirë nuk mund të jetë e tillë nëse nuk kalon nëpër përndjekje. Jezusi thotë: “nëse mua më salvuan, edhe ju do t'ju salvojnë”. Shën Pjetri i nxit besimtarët të jenë të qëndrueshëm përballë përndjekjeve të pësuaara për shkak të Jezusit. Dhe, nga ana tjetër, ne kemi disa shembuj shprehës në figurat e Martirëve tanë. Nuk mundemi vetëm ta mbushim gojën me fjali të gatshme si ato që kemi përdorur me rastin e lumnimit të tyre: “Gjaku i martirëve është fara e të krishterëve”. Kjo është një e vërtetë që ka lidhje me secilin prej nesh dhe që duhet të jemi të gatshëm e të kujdesshëm ta pranojmë në jetën tonë si individë dhe si bashkësi. Kush ka sy dhe veshë të hapur ndaj fesë do të dijë t'i lexojë të gjitha format e përndjekjes të cilave u nënshtrohemi sot dhe që shpesh nuk janë aq të dukshme... e megjithatë, ekzistojnë, duke filluar nga ato që shoqëria na imponon kur, për shembull, do të donte të na bënte të bëjmë kompromise me stile jete që nuk kanë asgjë ungjillore. Edhe përballë këtij lloji përndjekjeje jemi të thirrur të japin përgjigjen tonë si të krishterë të bindur dhe të qëndrueshëm në fe.

Por, përveç përndjekjes, Ungjilli i sotëm na ka përshkruar edhe disa veprime që karakterizojnë besimtarin: “Në emër tim do t'i dëbojnë djajtë, do të flasin gjuhë të reja; në duar do t'i marrin gjarpërinjtë e, nëse do të pijnë ndonjë gjë që sjell vdekjen, nuk do t'u bëjë keq. Do t'i vënë duart mbi të sëmurë, e këta do të shërohen”. Fitorja mbi të keqen dhe realizimi i së mirës janë mundësi konkrete që secili prej nesh mund t'i vërë në veprim në jetën e vet.

Por edhe në bashkësinë e krishterë, kjo fitore mbi të keqen është e mundur kur jetojmë jetën sakramentale: pagëzimin me heqjen dorë prej së keqes dhe prej mëkatit, rrëfimin që na vë përsëri në bashkim me Hyjin dhe me Kishën, vajimin e të sëmurëve për faljen e mëkateve dhe shëndetin e trupit e, mbi të gjitha, Eukaristinë. Edhe Sakramentet janë rast për të dëshmuar fenë tonë në Zotërinë e Ringjallur, por, në atë masë në të cilën jetohen mirë. Kujdesi për kremtimet tona liturgjike, edhe kur nuk bëhen me solemnitet, e lejon gjithë këtë. Nuk duhet të harrojmë se shën Agustini shkruan në Rrëfimet e tij se, pjesëmarrja në liturgjinë e Kishës ka qenë një prej dëshmive më të bukura që ka marrë dhe që e ka lehtësuar kthimin e tij nga Krishti.

Vëllezër e motra, ndërsa po bëhemi gati të kremtojmë përvjetorët tanë të mos lëmë pa u kujdesur për bashkimin tonë me Krishtin, pra, për rifitimin e identitetit tonë dhe misionin e mrekullueshëm që na takon pikërisht pse jemi nxënës të tij dhe anëtarë të Kishës. Nëse do të mbajmë parasysh të gjitha këto elemente në kremtimet tona, do të kemi edhe mundësinë të dëshmojmë dhe t'i tërheqim të gjitha nga Krishti; vetëm të cilit i qoftë lavdi e ndera për të gjithë shekujt e shekujve. Amen.





Prej shumë kohësh, Zoja e Këshillit të Mirë që kremtohet më 26 prill është shpallur nga etrit e Kishës në Shqipëri dhe është konfirmuar nga Papa si Pajtore e popullit shqiptar. Prandaj çdo 26 prill Kisha në Shqipëri edhe këtë vit kremtoi solemnish të kremten e Pajtores në Kishën e Zojës – shejtnore kombtare dhe tejet e dashur për të devotshmit e njërëzit besimtarë. Këtë vit Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë donte që po atë ditë të kujtohej edhe vizita e Papës Shën Gjon Pali II në Shqipëri, më 25 prill 1993 (25 vjetor). Prandaj në meshën

ipeshkvinjtë e Shqipërisë, Nunci Apostolik, një numër i madh meshtarësh e popull pa fund. Ishin të pranishëm në këtë kremtim, Shkëlqësia e Tij, Presidenti i Republikës, Baba Mondi nga Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve si dhe autoritete të tjera.

Meshën e udhëhoqi Imzot Angelo Massafra, i cili, në fillim të këtij kremtimi përshëndeti besimtarët dhe autoritetet kështu:

“Të dashur vëllezër dhe motra, sot kemi arsye të shumta për ta falenderuar të Shenjtnueshmen Trini: i gjithë ky kremtim eukaristik le të jetë një hymn falenderimi për Vizitën Apostolike historike të Shën Gjon Palit të II, dhe për dhuratën e katër ipeshkvinjve të parë pas komunizmit, duke vlerësuar, kështu, Kishën tonë martire.

Një falenderim i veçantë, vëllezër e motra, u shkon të gjitha Autoriteteve shtetërore, lokale, ushtarake dhe kishtarë (dua të përmend Imzot Ivan Dias, Nunci Apostolik), për përgatitjen dhe realizimin e vizitës historike, që pati një sukses të madh. Një falenderim i fortë dhe i ngrohtë të gjithë popullit shqiptar, juve, për pritjen e hareshme të Papës: Shën Gjon Pali i II: nga qielli Ai lutet për të gjithë ne.

Falenderojmë Hyjin edhe për atë që Kisha jonë është sot me kontributin e të gjithë atyre që e kanë bërë të bukur dhe që vazhdojnë ta zbukurojnë me dëshminë e tyre të fesë dhe të angazhimit apostolik: laikët, meshtarët, rregulltarët dhe rregulltaret të mbijetuar komunizmit, misionarët dhe misionaret, të djeshëm dhe të sotëm, thirrjet e reja meshtarake dhe rregulltare.

Falenderojmë Zotin akoma për shpalljen të Shenjtë, të Nënë Terezës së Kalkutës dhe për Lumnimin e 38- martirëve: Imzot Vinçens Prennushi dhe 37-shokët e tij.

Falenderojmë të gjithë bamirësit, pa dallim, për kishat që kemi restauruar dhe ndërtuar, për shkollat, për shërbimin në edukimin e brezave të rinj, për kujdesin ndaj të varfërve dhe të braktisurve nga shoqëria.

Falenderojmë Zotin për këtë ditë të bukur që po kremtojmë sot.

Për të gjitha këto themi faleminderit, edhe pse të vetëdijshëm se megjithëse kemi realizuar shumë, ende shumë mbetet për të bërë, sidomos përsa u përket thirrjeve: Kisha jonë për tu rritur ende ka nevojë për thirrje në jetën rregulltare dhe në meshtari; Zoti thërret, por familjet katolike duhet të bëhen më të ndjeshme ndaj zërit të Zotit dhe të favorizojnë përgjigjen e bijve të tyre ndajftesës së Krishtit për ta ndjekur në rrugën e shugurimit”.

Në fund të kremtimit edhe Rektori i Shejtnores, Dom Vlash Palaj, falenderoi Zotin dhe të pranishmit për bukurinë e bekimin e këtij kremtimi.

Edhe gurët marrin jetë kur Zoja e bijtë e saj rrinë së bashku në lutje aty.

**Kremtim për
Zojën e Këshillit të Mirë
25 vjet nga vizita e Gjon Palit II**



Kujtesë e ndodhi ...

Komuniteti Shqiptar në Jacksonville, Florida, kremton Festën e Pashkëve.

Në Shtetin e Floridas, në qytetin Jacksonville, jeton një komunitet Shqiptarësh prej më shumë se 15 mijë vetë, Komuniteti Katolik i të cilit u mbledh për të kremtuar festën e Pashkëve 2018. Falë përkushtimit të Dom Gjoanit, vetë Ipeshkvi i Dioqezës së Shën Augustinit, Imzot Felipe Estevez, kishte zgjedhur komunitetin tonë për të nda me ne Meshën e Shejt në kremtimin e ngjalljes së Krishtit. Në fund të meshës Ipeshkvi iu dhurua portretet e Shenjtës Nanë Tereza i punuar nga një familje e besimit muslimanë që jeton po aty.

Në datat 28-30 prill 2018, me ftesë të Fortlumbturisë së Tij Kryepeshkopit Anastas, Patriarku Fort i Shenjtë i Moskës dhe i gjithë Rusisë Kirili vizitoi për herë të parë Shqipërinë.



Më datën 2 maj 2018, Dom Raffaele Gagliardi, famullitari i Gurit të Zi, kremtoi 25 vjetorin e shugurimit të tij meshtarak. Ky kremtim u kryesua nga vetë ai në kishën e Zembrës së Krishtit në Gur t'Zi, në praninë e Arqipeshkvit, shumë meshtarëve dhe motrave, besimtarëve të famullisë si dhe të familjarëve dhe miqve që i kishin ardhur nga Italia.

Redaksia uron nga zemra dom Raffaelen dhe nxiti lexuesit të lutën për meshtarët dhe thirrje të reja meshtarake.



Më datën 3 maj 2018, në ambientet ndihmëse të kishës Katedrale në Shkodër, u inaugurua Salla e re e Muzeut Dioqezan e cila i bashkohet Sallës së parë dhe ky Muze dioqezan kërkon kështu të ofrojë një kontribut për të kujtuar martirizimin dhe rezistencën fisnike të klerit dhe popullit katolik shqiptar.

Muzeu mund të vizitohet nga të gjithë çdo ditë.



Muzeu DIOQEZAN

Më datën, 9 maj 2018, Famullia e Shkrelit në Malësinë e Madhe, kremtoi festën e famullisë. Famullitari, Dom Nikolin Toma kishte thirrur për të udhëhequr meshën në nderë të Pajtorit, Sh. T. Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult.

Po më 9 maj 2018, Famullia e Shën Kollit Velipojë, kremtoi festën e famullisë. Famullitari, Dom Marjan Gega kishte thirrur për të udhëhequr meshën në nderë të Pajtorit, Sh. T. Imzot Gjergj Metën, Ipeshkëv i Rrëshenit.

Më datën 10 maj 2018, Famullia e Dajçit të Bregut të Bunës, kremtoi festën e famullisë, T'Shëlbuemit. Famullitari, Dom Gjovalin Simoni kishte thirrur për të udhëhequr meshën në nderë të Pajtorit, Sh. T. Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult. Gjatë meshës u dha për adoleshentët e përgatitur edhe sakramenti i Krezmimit.

Nga data 14 -16 maj zhvilloj punimet e zakonshme Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë.

Si çdo vit, shqipëtarët në Itali janë bashkuar të dielën e fundit të majit, më 27 maj 2018, tek Shenjtërorja e Zojës në Gjenacan të Romës. Nën kujdesin e dom Pasquale Ferrara – rektor baritor për shqipëtarët në Itali dhe dom Mark Pashkja përgjegjës baritor për shqipëtarët në Romë u organizua ky kremtim shumë i dashur. I ftuar për të udhëhequr kremtimin ishte Sh. T. Imzot Gjergj Frendo, Arqipeshkëv Metropolit i Tiranë-Durrës dhe President i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.

Muaji i majit – muaji i Zojës, zbukurohet veçanërisht nga devocioni që kanë besimtarët e krishterë e jo vetëm për Marinë – Zojën e bekume. Në mënyrë të veçantë ky devocion shprehet në shtegtimet e përditshme që zhvillohen tek kisha e Zojës poshtë Kalasë. Mijëra besimtarëve që zbukurojnë Shejtnoren me lutje e përsëritje u ka shërbyer Rektori i Shejtërores njëheri famullitari i Katedrales, Dom Vlash Palaj, ndihmës-famullitari Dom Gaspër Kola, shumë meshtarë nga ata të thirrur për të kremtuar çdo ditë të muajit maj, motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore dhe bashkëpunëtorët që u angazhuan në mbarëvjetjen gjatë gjithë muajit të Zojës.



Me dt 15 Maj 2018, tek Fshati i Paqes, Projektit Shpresa, Instituti i Motrave të Nënë Terezës dhe Shoqata “Madoninna del Grappa” u mbledhën së bashku me rastin e Ditës Botërore të Familjes. Aktiviteti u titullua: “Një shëtitje me familjen”.

Requiem për stigmatinen Leza Preka



“Unë jam ringjallja dhe jeta, kush beson në mua edhe nëse vdes jeton, e kushdo që jeton nuk do të vdesë më kurrë”. Gjn 1, 25

Motër Leza Preka

lindi me 1 qershor 1961 në Dukagjin.

Motër Leza, vjen nga një familje e thjeshtë me tradita fetare, kulturore e mikpritëse.

Më 3 maj 1993, motër Leza filloi hapat e parë për t'iu kushtuar Zotit, në Kuvendin e Motrave Françeskane Stigmatine, Shkodër. Ishte ndër frytet e para të thirrjes në Kishën tonë Shqiptare, pas rregjimit komunist. Motër Leza, arriti një formim të pasur teologjik, shoqëror e profesional, duke ndjekur kështu studimet e larta në Institutin Katekistik, Universitetin e Degës së Infermierisë si dhe shumë kurse tjera profesionale. Më 08.12.1998 bëri Kushtet e Para e me 17.09.2005, mori Kushtet e Përgjithshme.

Ju shërbeu me kujdes e respekt të veçantë motrave tashmë të moshuara si e bashkëmotër dhe infermiere. Pa marr parasysh orarin apo lodhjen e saj, u shërbeu edhe shumë të sëmurë tjerë nëpër familje të qytetit të Shkodrës.

Ajo i pati shumë për zemër të varfërit dhe të sëmurët, pothuajse e kishte për “karizëm” t'u shërbente atyre, duke qenë për ta, për 15 vite radhazi nënë-motër . E përvetësoi me nder Përshpirtërinë e Themelueses sonë, Sr Anna F. Lapini: “ Të shërbejmë të Kryqëzuarin në të kryqëzuarit e kohës”.

Kishte karakter të fort e vullnet të pathyer. Pranoi me besim e për dashuri vuajtjen që jeta ia afroi, si mjet bashkimi me Jezusin, edhe kur sëmundja avanconte, me vetëdije të plotë e dëshirë të madhe nuk donte kurrë të dorëzohej së shërbyeri ndaj Personave me Aftësi Ndryshe të Shoqatës, Madonnina del Grappa. Tashmë dukej se këta persona ia kishin kapluar zemrën sa që siç thoshte edhe vet Motër Leza, ishin bërë pjesë e jetës së saj. Për të ishin “princa, yjet e botes”, e përsëri thoshte: “për ta jetoj, ata janë gëzimi i jetës sime”. Nuk njohu sakrificë, as orar, as lodhje, as

dhimbje, madje as turp të të mbarte përgjatë qytetit, një thes në shpinë apo biçikletë të ngarkuar me rroba, derisa t'ju plotësonte atyre gjithçka kishin nevojë.

Ndërroi jetë më 19/04/2018, që varrosur më 21/04/2018 tek varrezat Katolike të Rrmajit Shkodër.

Ndarja jote prej nesh na prek zemrën por edhe na forcon dëshirën në kushtimin e jetës sonë ndaj Zotit dhe në shërbim të të varfërve. Sikurse ti e zbatove deri në ditët e fundit. Ajo gjatë jetës së saj na pasuroi me dhuratat njerëzore dhe shpirtërore, për të cilat ne jemi krenarë dhe mirënjohës. Zoti e deshi tek vetja, me kurajo ajo ka thënë deri në fundin e jetës: “Ja ku jam! Si e kur të dojë Zoti! Gjithçka kam kryer!”

Në ceremoninë e Meshës së shenjte të udhëhequr nga Sh. T. Imzot Angelo Massafra, morën pjesë shumë meshtarë, rregulltarë, laikë, ndër të tjera edhe Motër Chiara Pieri, ish misionare për 23 vite në Shqipëri, Motër Dukata Radoja Sekretare gjenerale e cila i përcolli ngushëllimet amnore të Eprorës së Përgjithshme e të gjitha motrave të Kongregatës.

Motër Leza, lute Zotin bashkë me të lumen Marie Tuci dhe Martirët tanë, për Kishën në Shqipëri, për ne motrat tua Stigmatine. Pushoftë në Page!



**LETËRSI E VRARË ...**

Visar Zhiti

“Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar” është një sprovë që kërkon të dëshmojë me emra dhe vepra që në vendin tonë, mbas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, me t'u vendosur regjimi i 'Diktaturës së Proletariatit', krahas letërsisë zyrtare, pra, Realizmit Socialist, të vendosur me forcë, u lëvrua në fshehtësi heroike dhe një letërsi tjetër, në kampe internimi dhe burgje, që rrëfente pikërisht vetveten, vuajtjen dhe shtypjen. Kjo letërsi jo vetëm nuk botohej dot, por po të zbulohej, dënohej. Dënohej autori dhe lexuesi dhe vetë vepra. Janë pushkatuar shkrimtarë, janë burgosur lexues, janë djegur libra.

Pas rënies së perandorisë komuniste, kur dhe Shqipëria jonë “hoqi qafet” diktaturën e saj, 'Letërsia e dënuar', ajo e fshehta, nisi të dalë në dritë, duke sjellë ato që mungonin, mbi të gjitha të vërtetën dhe moralin, pa të cilat nuk letërsi të madhe, sipas Franc Kafkës.

Dhe pamë që shpesh kjo letërsi është shkruar nga martirë të fjalës së lirw e të besimit, pra është dhe vetë letërsi martire.

Nga “Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar” po sjellim disa pjesë ku sintetizohen disa nga ata autorë që i vranë ose vdiqen burgjeve.

* * *

Vdisnin apo i vdisnin? E thërrisnin vdekjen, që aty ishte pas derës së qelisë, natë e ditë, apo e prisnin të vinte bashkë me oficerin e rojës? Guxonin të shkonin drejt tyre?

Shkrimtari plak, ai që kishte shkruar romanin e parë shqip, kur gjuha shqipe ishte ende e ndaluar nga qeveria e pushtuesit turk, dom Ndoc Nikaj, do të mbyllte sytë në burg. E arrestuan në moshën 82-vjeçare, më 1946, me akuzën se donte të përmbyste me dhunë pushtetin e porsavendosur të komunistëve. 1889, fundi i shekullit XIX. Ndoc Nikaj boton romanin e parë, “Marcja”. Një epikë plot dramë dhe mistikë, ku mahnitshëm sikur gëshetohen fantastikja e baladave ballkanike e tonat. Një vit pas Shpalljes së Pavarësisë, boton romanin tjetër “Shkodra e rrethuese” në formë ditari, që s'e di pse, në historinë e letërsisë shqipe do të konsiderohet ky, ja, ashtu si me gjysmë zëri, si romani i parë shqiptar dhe jo i mëparshmi i një shekulli më përtej. Pse? Ngaqë vendoste diktatura dhe e përzgjidhte temën? Madje dhe autorin. Diktaturë dhe mbi të kaluarën, historinë. Babai i romanit shqiptar, Ndoc Nikaj, ka dhe 7 romane të tjera të pabotuara, edhe drama etj. Vunë prangat mbi ato duar që duhej t'i puthnin. Sikur donin të dënonin ashtu së paku dhe ata 500 vjet punë të klerit katolik shqiptar. Ai, i bardhë në qeli. E kishte menduar varrin, por jo burgun nga bijtë e tij. I pa, i duroi dhe 5 vjet. Teksa shekulli kaloi mesin e vet, Ai kaloi në botën e të vdekurve. Ndoc Nikaj është i pavarr, por edhe vepra.

At Bernardin Palaj. Dijetar në poetikë, autor poemash, si “Vorre të flamurit”, “Moskë-Alkazar”, “Prej burgut të jetës” (dhe në burg do të përfundonte), “E diellja e fundit në Aventin”, dhe njëkohësisht poezia e tij e fundit. Do të botonte në prozë librin “Mikpritja e maleve”, ndërkaq do të merrej gjatë me folklor për Visaret e Kombit. Veglat e torturës, hekuri i tyre, duke u përzier me gjakun, i futën sëmundjen e tetanozit dhe vdiq në burg.

At Donat Kurti, bashkëpunor i Palajt, të dy përfunduan “Kangë kreshnikësh dhe legjenda” për Visaret e Kombit dhe më pas në dy vëllime mbloodhi “Përrallat kombëtare” duke u vlerësuar si një Andersen shqiptar, nga albanalogët si N. Jokli etj. Përfundoi në burg, botoi dhe librin me tregime “Në rrugën e plepave”, ku edhe vdiq ashtu, në një si rrugë, ku era vërshëllente si plumbi ...

Imzot Vinçenc Prendushi, lirik në përmbledhjen “Gjethe dhe lule”, folklorist i shquar, studiues dhe autor i dramës “Prej robnie në liri”, përkthyes i nobelistit polak Sinkieviç, por edhe “Burgjet e mia” të Silvio Pellico-s dhe do ta dënojnë edhe atë me 20 vjet burg. Vdes në qeli duke pasur te kryet shkrimtarin Arshi Pipa. Ç'porosi i la para se të shkonte te Zoti?

Xhevat Korça ... gjyqi e dënoi me vdekje, i shkolluar nëpër Europë, eseist, albanalog, historian, themelues i gjimnazit shtetëror të Shkodrës, i Institutit të Studimeve Shqiptare, anëtar i Këshillit të Shtetit, Ministër i Arsimit, mbi të gjitha patriot, autor i një vepre për Skënderbeun, përkthyes i Shilerit, “Cubat”, dhe hulumtues mahnitës. I vetëm ia doli që në arkivat e Beogradit dhe të Vjenës të qëmtojë e të përkthjëjë mbi 5000 faqe dokumentacion “Acta & diplomata Austro-Ungarie” e gjithçka ç'shkruhej për Shqipërinë, të cilat janë ende të mbyllura në Arkivin e Shtetit Shqiptar.

At Anton Arapi, sociolog dhe prozator, autor i një Lahute Malcie në prozë, “Andrra e Pretashit”, që teksa shpalon virtyte shqiptare, i bashkëngjit dhe ato gjuhësore, që do të përthellohen te “Vlerë shpirtnore”, “Shqiptari dhe bota e tij” dhe “Valë mbi valë”. Problemet dhe mënyra se si i shtron, stili i vrullshëm, etika e lartë evropiane, apeli për një rimëkëmbje të breznive dhe kombit dhe të unitetit, i japin kumbim aktual.

Kur e çonin drejt pushkatimit, nuk binte asnjë kampanë, ndërsa ai kujdesej udhës që zhguni të mos i bëhej me baltë.

Një vit më pas pushkatuan dhe intelektualin e lartë **At Gjon Shllaku**, i edukuar në liceun “Illyricum” të franceskanëve në Shkodër, që më pas do të merrte leksione në tri universitete në Holandë, Belgjikë e Francë. Laurohet në degën e Filozofisë në Sorbonë, Paris. Botoi në revistën “Hylli i Dritës”. Batareja e plumbave shembi gjithçka. Terr.

Autor fjalorësh, i më të mirit të fjalëve të rralla dhe i atij onomastik etj., **Nikollë Gazulli**, vepra e të cilit përmendej, por jo emri, sepse e vranë, pa gjyq fare, i rrethuar nga bandat komuniste, ra si martir në një shpellë, ku ishte futur për t'iu shmangur terroristëve të kuq. Nuk ka varr. As shpellën. Por jo kujtesën e fshehtë të kohës.

Aleksandër Sirdani, mbledhës folklori, studiues pasionant, autor i mijëra faqeve në dorëshkrim, u torturua nga oficerët e fitimtarëve dhe trupin e copëluar e shëtitën andej nga Kopliku për të llahtarisur njerëzinë. E goditnin me sfurk, e bënë vrima-vrima si t'i kishte rënë breshërima e plumbave, dhe e vërvitën në një gropë të zezë.

Dhe një arbëresh... **Terenc Toçi** (Terenzio Tocci), nga Strigari i Zef Serembes, që u shkollua në Shën Mitër, në kolegjin iluminist të De Radës. Kishte ankthin e dheut amë, të lirisë së tij dhe erdhi në Shqipëri e ngriti Flamurin një vit më parë se Ismail Qemali. Në gjyq, e nxorën të lidhur bashkë me personalitete të tjera aty te kinema “Savoja”, që ishte bërë Teatri Kombëtar, në një nga lozhat e së cilës vëzhgonte me monokël diktatori i ri Enver Hoxha. “Pushkatim!” - ulërinte gjenerali partizan, Bedri Spahiu. Po biblioteka e tij, mijëra vëllime, botime edhe të shekullit XIV, edhe pergamena? Të 17 vetat i hipën në një kamion të mbetur nga lufta. Ishte prilli '45. Dhe një gropë e madhe, e pamëshirshme si krimi. Në muzg qëlluan mbi ta, breshër plumbash. Dhe mbas 50 vjetësh, kur kishte rënë perandoria komuniste, u gjetën skeletet e tyre. Shkroi dhe media italiane, ajo arbëreshe patjetër.

Dhe një grua, o Zot! **Zonja Sabiha Kasimati**, shefe e sektorit të zoologjisë, hulumtuese dhe studiuese e faunës ihtiologjike detare dhe liqenore shqiptare, s'mundi ta botonte veprën e saj të gjerë, sepse guxoi dhe akuzoi Enver Hoxhën si diktator. Arrestohet midis 81 intelektualëve antikomunistë për hedhjen e bombës në ambasadën sovjetike dhe pa gjyq pushkatohet mes 22 të tjerëve. E vetmja grua... Po në skuadrën e pushkatimit kishte grua?

Dhe do të vazhdohej me poetët. Do të pushkatonin babanë bektashian Ali Tomori, Manush Peshkëpinë dhe...

... biri i një familjeje të thjeshtë në Zagori, Trifon Xhagjika, pasi kreu studimet e larta, shërbeu në ushtri. E arrestuan në grup më 1963 dhe po atë vit e dënuan me pushkatim. 31 vjeç. “Atdheu është lakuriq”, me këtë titull do të botonim librin e tij të parë me vjersha, pas rënies së diktaturës, do ta përgatitte liriku Jorgo Bllaci, ish-i burgosur, dhe punonim së bashku në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”. Po ku është varri i Trifon Xhagjikës? Balta s'tregon asgjë.

... I fundit, i dënuar me varje në të gjithë perandorinë komuniste, poeti nga Kukësi **Havzi Nelaj**. Një vit para se të shembej Muri i Berlinit, më 1988, u ngrit trekëmbëshi i drunjtë për të, brenda në qytetin verior, mu te stacioni i autobusëve, ku prisja gjatë dikur, të gjeja një mjet për të shkuar pas maleve, ku isha mësues. Edhe Havzi Nelaj kishte qenë mësues dhe ishim njohur në burg bashkë. Shtynim vagonët me mineral si skllevër dhe kisha pasur rastin të flisnim pak dhe ... për poezinë. Çuditërisht. Kishte një si buzëqeshje të përhershme në fytyrë, duhej të ishte mirësia e tij e pikëlluar, dhe kokën e mbante të anuar paksa nga njëri sup ... si të varurit. Pasi kryen shkollën pedagogjike në Shkodër, Havziu do të shkojë të punojë në Mat, por bëhen shkak disa vjersha dhe e zbojnë nga arsimi. Dhe prapë poezia do të jetë shkak që e përjashtojnë nga universiteti, të cilin e vazhdonte me korrespondencë. Dhe vendos të arratiset. Në Kosovë. Por e kthejnë dhe e dënojnë me 15 vjet burg. E çojnë të lidhur me pranga në Spaç. ... Kur lirohet, nis internimi. Prapë konfliktohet me rendin, madje ka një armë tani, ilegale, dhe e zbraz për vetëmbrojtje. Edhe poezinë e ka ilegale. Diktatori kishte 3 vjet që kishte vdekur, por jo diktatura. Dhe e varën, 54-vjeçar. Në stacionin e autobusëve, që udhëtarët ta merrnin me vete pamjen e llahtarshme. Ku ta çonin? Në të ardhmen? Dhe ishte viti kur po përpëlitej jo vetëm trupi i tij në litar, por edhe komunizmi. Varja e fundit, teksa në kufi qëllonin me armë djem të rinj që donin të iknin dhe i zvarritnin të vdekur. Kur të pyesni :“Ku e ka vorrin?”. As ajri s'do ta tretë imazhin. Megjithëse të dënuarit kundër regjimit s'kishin varr. Varri i Havzi Nelës tani është libri i tij me poezi “Asnjë çast lumniye” me nëntëmbëdhjetë krijime. E shfletojmë. Ai është i pari dhe i vetmi që shkroi poezi për të drejtat e njeriut, që përmend Helsinskin, kur ishte i ndaluar, madje s'e dinin ç'ishte. Protestat në Kosovë, 1981.... Ja ç'kishte shkruar në burg:

Lavdi çikës kosovare

Si një shqerrkë, si një manare.

I del tankut, i thotë “Ndall!”,

Rritet, ngrihet sa nji mal!

Kështu ndodh dhe me shpirtin e tij... dhe me shpirtrat e tyre.

... nga Dioqeza e Sapës

NJËZET E PESË VJET PRANI E ETËRVE KAPUÇIN NË SHQIPËRI
(1993 – 2018)

Edhe pse burimet historike janë të pakta, prania e parë e etërve kapuçin italian në Shqipëri i ka fillimet e saj në shekullin XVIII.

Në 1985, me rënien e diktatorit komunist Enver Hoxha, njëfarë ideje e demokracisë u instaurua në Shqipëri, derisa në shkurt të 1991 regjimi komunist u zhduk krejtësisht, nën nxitjen e rregullave të reja social-ekonomik, pas rënies së Murit të Berlinit. Në Puglia u verifikua grada e parë e refugjatëve shqiptarë, rreth njëzetmijë, mbi anijen e Vlorës në portin e Barit, në gusht 1991. Bëhej fjalë për një ngjarje të re, të shkruar në historinë e gjatë, akoma e pambaruar, të migrimit të popujve në detin tonë. Kështu nga Kuria Gjenerale e Urdhërit u nisën kontaktet me Provincën e Puglies, për të vërejtur mundësinë e dërgimit të vëllezërve misionarë, përtej bregut të detit.

Fretërit Lorenzo Invidia, Ministër provincial në detyrë, dhe misionari i parë Sergio La Forgia u pritën dhe përjetuan mikpritjen e parë nga Etërit Rogacionist dhe nga Dom Injac Dema, në shtator 1993, dhe u vendosën në fshatin Nënshat, në fushën e Zadrimës, saktësisht në një kazermë të rrënuar të shitur nga shteti. Afër kanonikës së vjetër të meshtarit të Nënshatit u ndërtua kisha e parë e fshatit kushtuar shën Mëhillit Kryeengjëll. Ndër vite rrezja e veprimit baritor të etërve Kapuçinë në Zadrimë u zgjerua, duke përbledhur fshatrat e Hajmelit e Dheu Lehtë ku ndërtuan Kishat famullitare kushtuar Shenjtërve Pjetrit dhe Palit, dhe kisha e dytë Shënjtës Farë.

Ndërkohe në Tiranë ishte rihapur Nunciatura Apostolike; në Shkodër u restaurua “kisha e madhe”, ashtu si të krishterët gjithmonë e kanë quajtur katedralja e Shën Shtjefnit. Me 25 prill 1993 shën Gjon Pali II, i ardhur me qëllim në Shqipëri, shuguroi në Shkodër katër Ipeshkvinj të rinj, duke e rikthyer hierarkinë kishtare. E bekoj edhe gurin e parë të Shenjtërores kombetare mariane, kushtuar mbrojtjes së Vendit, Zoja e Këshillit të Mirë, tashmë e rrënuar si pjesa më e madhe e kishave dhe xhamive pas 1967.

Disa të rinjve me dëshirë për të njohur më mirë jetën tonë franceskane-kapuçine iu ofrua një mundësi studimi dhe formimi në Shkodër. Arqipeshkvi i kohës, Shkelqësia e tij Imzot Frano Illia, e lejoi në përdorim një pjesë të tokës mbi kodrinën e Taraboshit, ku ishin edhe rrënojat e vjetra të kishës së vogël të Shën Marisë Magdalenë. Në rrethinën tonë, të afërmit e shtëpisë sonë ishin dhe janë nga dy etni të ndryshme rom, magjypë e gabel. Për t'i bindur prindërit që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, në vend që të kërkojnë lëmoshë, fretërit, për një intuitë të kënaqshme të fra Bonaventura Mossuto, hapën një shkollë parësore ku mësonin për të shkruar dhe lexuar deri në klasën e pestë. Pas 20 viteve e më shumë vepra e tillë sociale është aktive nën mbrojtjen e të Lumit Zeferin.

Në 1998 u ndërtua kisha afër kuvendit në Tarabosh, ndërsa për punën baritore fretërit vazhdonin ta përhapnin në qytetin e Shkodrës, në fshatrat e Zadrimës e në famullinë e Shën Nikollës, në Laç Vau Dejes, e bërë qënder e rithemelimit të dioqezës së Sapës, e zgjedhur që nga viti 1062 nga Papa Aleksandri II. Në vitin 2000 e më pas, me riorganizimin e dioqezës, u hapën misionet në male ku fretërit minor kapucin kanë vepruar në zonat Gjegjan, Kryezi dhe në Dukagjin.

Në gusht 2007 iu shtua fra Andreas Waltermann (Provinca Gjermane), që jetoj në muajt e parë në Nënshat dhe pastaj, gjithmonë në dioqezën e Sapës, në shërbim të bashkësisë së Fushë - Arrëzit dhe në shumë fshatra të tjeratë varfëra përreth, në zona malore, mbi rrugën drejt kufirit me Kosoven.

Me P. Andreas, fretërit, motrat Stigmatine dhe vullnetarët shqiptarë e italianë janë realizuar çdo verë kampe për fëmijë dhe të rinj, bekime të familjeve, iniciativa të ndryshme ungjillëzuese. Në realitet bëhet fjalë për një zonë shume të pafat, që vazhdon të paraqesë të gjithëve efektet e një misioni në mision.

Për situatën e dobët shendetësore në zonën e Nënshatit fretërit panë

nevojën për të ndërtuar një poliambulator, të përruar në shtator 2012, së bashku me kishën e re famullitare të shën Mëhillit Kryeengjëll.

Nga viti 2009 deri në vitin 2015, në mungesë të thirrjeve misionare, qe vendosur që të pezullohet prania e një bashkësie kapuçin stabël në kuvendin e Taraboshit, dhe në shtator 2015 u konkretizua mundësia që të dërgonin fretër të rinj që të jetonin në të njëjtin kuvend. Aktualisht bashkësisë së Taraboshit i është besuar kujdesi baritor i fshatrave të Barbullushit, Shiroka e Muriqani.

Në Nënshat Bashkësia “Papa Gjon XXIII” ka marrë në përdorim një shtëpi të fretërve, për bashkësinë e rehabilitimit për ish-toksikodipendetët. Afër bashkësisë së besuar fretërve është duke u bërë përhapja e karizmës franceskane edhe përmes Urdhërit të Tretë Françeskan shekullar dhe të Rinisë Françeskane.

Aktualisht fretërit Kapuçin të pranishëm në territorin shqiptar janë: fra Bonaventura Mossuto, fra Giuseppe Lanzellotti e fra Matteo Di Seclì në kuvendin e Nënshatit; fra Prel Sylja, fra Piergiorgio Taneburgo, fra Gjon Shtjefni e fra Dario Ardillo, misionari i fundit i shtuar janë të vendosur në kuvendin e Taraboshit, ndërsa fra Andreas Waltermann vazhdon misionin e tij në Fushë Arrëz.

Fretërit e tjerë kanë qenë zëvëndësuar ndër vite në shërbim të kësaj toke të mrekullueshme: fra Sergio La Foggia, fra Angelo Argese, fra Giuseppe Maselli, fra Antonio Imperato, fra Massimo Tatullo e fra Salvatore Chierico. Aktualisht është student në Bari në vitin e fundit të teologjisë fra Reoland Marku. Vëllezërit e tjerë janë ndryshuar këtë vit për eksperiencë të shërbimit dhe formimit që gjithnjë e më shumë e kanë forcuar lidhjen mes Provincës së Puglies e Shqipërisë.

Në kujtim të këtyre 25 viteve të para të misionit në Shqipëri fretërit Kapuçin i janë mirenjohës Zotit për veprën e tyre misionare ungjillëzues dhe i japin lavdi Hyjit për mrekullitë që bënë në këtë tokë të bekuar dhe të ujisur me gjakun e Martirëve.

Etërit Kapuçin - Nënshat






1973

2018

In memoriam: 45 Vjet nga Revolta e Spaçit



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Dom Gjovalin Sukaj

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesia
Luigj Milla

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë